

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit
Titulli i lëndës:	Menaxhmenti në Hoteleri dhe Turizëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Aberta Tahiri
Detajet kontaktuese:	alberta.tahiri@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda ka për bazë përgatitjen dhe aftësimin e studentëve për menaxhim bashkëkohorë të turizmit dhe hoteliersë, formimin e tyre si menaxherë të motivuar dhe të orientuar në shërbime turistike cilësore dhe të qëndrueshme. Lënda ofron sigurimin e bazës teorike cilësore dhe sasiore për studentët përmes kuptimit të strukturës dhe funksionimit të sistemit turistik.</p> <p>Gjithashtu, përmes analizës së rasteve të studimit, studentët do të gjenden në pozitën e një bashkëpunëtori profesional apo menaxheri, i cili duhet të zgjidhë një problem të caktuar. Kështu studentët duke analizuar gjendjen aktuale të një organizate apo destinacioni turistik duhet të identifikojnë problemin e caktuar dhe të japin rekomandimet e duhura për tejkalimin e tij, sepse kjo do të ndihmojë që ata të kenë qasjen e dëshiruar në menaxhimin e turizmit dhe hotelierisë.</p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analiza e gjendjes dhe indentifikimi i faktorëve determinues për zhvillimin turistik; ▪ Funksionimi i një destinacioni turistik; ▪ Shfrytëzimi i potencialeve turistike në kohë dhe hapsirë; ▪ Zhvillimi i produktit turistik; ▪ Zhvillimi i ofertës cilësore turistike; ▪ Zhvillimi i politikave të favorshme turistike; ▪ Aplikimi i metodave dhe teknikave të domosdoshme për hartimin e strategjisë; ▪ Hartimi i planit strategjik për zhvillim të turizmit dhe hotelierisë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studenti pas përfundimit të studimeve duhet të jetë në gjendje të:

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Demonstroj aftësi në menaxhim të biznesit; ▪ Llogaris dhe analizoj aktivitetet biznesore që të maksimizoj efektin e vendimarrjes në biznes; ▪ Të njoh trendet e industrisë si dhe të analizoj ambientin e jashtëm dhe të brendshëm biznesor për të zhvilluar strategji biznesi për industrinë e turizmit dhe hotelerisë; ▪ Zhvilloj aftësi të ndërmarrësisë me ide inovative.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	4	8
Ushtrime në teren	3	2	6
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provim final)	2	1	2
Projektet, prezantimet , etj			
Totali			125

Metodologjia e mësimdhënies:	Ky kurs organizohet nëpërmjet të ligjëratave, punës në grupe të studentëve, pjesëmarrjes aktive në diskutime dhe diskutime të rasteve studimore. Përveç materialeve nga ligjëratat, të cilat përmbajnë konceptet themelore të menaxhimit të turizmit dhe hotelerisë, studentët do të lexojnë dhe artikuj nga revistat elektronike, sipas kapitujve përkatës. Ata do të marrin detyra për diskutim gjatë orëve ose për pune individuale dhe grupe. Studentët duhet të ballafaqohen me problemet reale të menaxhimit në fushën e hotelerisë dhe turizmit.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 0-30% Vlerësimi i dytë: 0-30% Ushtrimet, seminarët: 0-20% Hulumtimet shkencore,0-10% Interaktiviteti: 0-10 %

	<p>Provimi përfundimtar 100%</p> <p>Provimi final i vlerësuar me 100% të notës. Provimi përbëhet prej pyetjeve me përgjigje të mundshme, pyetje të hapura, dhe një rast të studimit.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Prof. Ass. Dr. Alberta Tahiri & Prof. Ass. Dr. Idriz Kovaçi, “Menaxhimi në Turizëm: Qasje Teorike Menaxheriale”, Pejë, 2017.</p> <p>Stephen J. Page, “Tourism Management: Managing for change”, Sixth edition, Routledge, New York, 2019.</p>
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lauren Starkey, “Hotel/Restaurant Management Carer Starter”, Leaning Express Editors, 2007. ▪ Vjollca Baku, “Menaxhimi i Turizmit”, Tiranë. ▪ Robert Christie Mill, “Restaurant Management: Customers, Operations, and Employees”, 3rd edition, 2007.
Përmbajta	<p>Gjeneza dhe zhvillimi i menaxhmentit bashkëkohor; Funksionet dhe detyrat e menaxhmentit; Nivelet e veprimit menaxherial; Teoritë e menaxhmentit; Organizimi si mjedis i menaxhmentit; Planifikimi, qëllimet e planifikimit strategjik dhe operativ; Organizimi, autoriteti dhe deligimi i tij; Personeli, Zgjedhja e burimeve njerëzore; Udhëheqja, Relacioni ndërmjet udhëheqësve dhe vartësve; Stilet e udhëheqjes; Kontrolli; Roli i komunikimit në menaxhim; Menaxhmenti dhe mjedisi menaxherial.</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njohja e studentëve me përmbajtjen e lëndës, mënyrën e vlerësimit dhe notimit, mënyrën e hartimit të punimit seminarik, si dhe njohja me literaturën përkatëse për lëndën
Java e dytë:	Kuptimi dhe roli i menaxhimit Llojet e ndryshme të menaxhimit
Java e tretë:	Menaxhimi si aktivitet universal Menaxhimi si profesion Menaxhimi si proces
Java e katërt:	Menaxhimi sot Hierarkia e menaxhimit Puna e menaxherit
Java e pestë:	Sfidat bashkëkohore të menaxherëve në ekonominë e turizmit Ndikimi i globalizmit mbi trendet turistike Karakteristikat e tregut turistik Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit si tendencë bashkëkohore në nivel global

Java e gjashtë:	Qasje teorike rreth esencës së kompetencave menaxhuese Karakteri i kompetencave menaxhuese Treguesit e kompetencave menaxhuese
Java e shtatë:	KOLLOKVIUMI I PARË
Java e tetë:	Fushat e kompetencave menaxhuese Organizimi i aktiviteteve të punës në ekipe Rëndësia e punës ekipore në hoteleri Kohezioni dhe efikasiteti i ekipit Roli i liderit në arritjen e efektivitetit grupor
Java e nëntë:	Kreativiteti dhe inovacioni i menaxherëve për krijimin e ofertës turistike Aftësitë komunikuese-faktorë për menaxhim të suksesshëm të hoteleve Roli i menaxherit bashkëkohor për udhëheqje në biznese të hotelerisë
Java e dhjetë:	Raporti ndërmjet strategjive zhvillimore dhe kontrollit në menaxhimin bashkëkohor të turizmit Strategjitë - qasja kreative në realizimin e avantazheve konkurruese
Java e njëmbëdhjetë:	Franshiza si strategji për dalje tregun ndërkombëtar turistik Kontrollingu si faktor për sjellje efektive strategjike të ndërmarrjeve hoteliere Llojet e kontrollit menaxhues
Java e dymbëdhjetë:	Menaxhimi bashkëkohor i turizmit Nivelet e menaxhimit në turizëm Menaxhimi i nivelit më të lartë në turizëm Menaxheri gjeneral në turizëm Përgjegjësitë e menaxherit gjeneral në turizëm
Java e trembëdhjetë:	Menaxhimi i turizmit në Kosovë Paraqitja dhe zhvillimi i turizmit në Kosovë Shkaqet e mos zhvillimit të deritanishëm të turizmit në Kosovë
Java e katërbëdhjetë:	KOLLOKVIUMI I DYTË
Java e pesëmbëdhjetë:	E ardhmja e turizmit dhe hotelerisë si dhe roli i menaxhimit në perspektiven e zhvillimit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.